

Vendim i Ortakëve

Sot në Borsh, më 7 Mars 2025 (dymijë e njëzet e pesë) është mbledhur Asambleja e Përgjithëshme e përfaqësuar nga Ortakët **"Fab Construction" Sh.p.k**, me Numër Unik **L22209024A**, me përfaqësues ligjor Z. Shaban Xhabrahimi që zotëron 70 % të vlerës së kapitalit ose një pjesë me vlerë 70,000 lekë dhe ortaku **"A.TOTO" Shpk**, me Numër Unik J64102219M, me përfaqësues ligjor Z.Andrea Toto që zotëron 30 % të vlerës së kapitalit ose një pjesë me vlerë 30,000 lekë pranë selisë së shoqërisë **"Grand Hotel Borsh" Sh.p.k** me Numër Unik M01414027F me rend dite të përcaktuar:

- Miratimin e fillimit të procedurës së vlerësimit të zmadhimit të kapitalit me kontribute në natyrë dhe kontribute në para.
- Miratimin e fitimit të së drejtës mbi pronat të cilat janë pranuar për transferim nga Ortakët e Shoqërisë **"Grand Hotel Borsh" sh.p.k**, aktive që do të kalojnë në zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë.
- Miratimin e fitimit të së drejtës mbi detyrimet të cilat janë pranuar për transferim me heqje dore ndaj së drejtës monetare nga Ortakët e Shoqërisë **"Grand Hotel Borsh" sh.p.k**, detyrime që do të kalojnë në zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë.
- Miratimin e caktimit të Audituesit Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) z.Halim Bakalli me Liç. 103, për hartimin e raportit të posaçëm, për vlerësimin e kapitalit nga kontribut në natyrë me aktive.

Formalizohet pjesmarrja në mbledhje e Ortakëve **"Fab Construction" Sh.p.k** me Numër Unik L22209024A me përfaqësues ligjor Z. Shaban Xhabrahimi që zotëron 70 % të vlerës së kapitalit dhe **"A.TOTO" Shpk** me Numër Unik J64102219M me përfaqësues ligjor Z.Andrea Toto që zotëron 30 % të vlerës së kapitalit, pranë selisë së shoqërisë **"Grand Hotel Borsh" Shpk** e themeluar më datë 11.02.2020, pajisur në të njëjten kohë me Numër Unik M01414027F, fituar zotësinë për të vepruar si person Juridik me datë 14.02.2020, me seli në adresën : "Rruga e Plazhit", nr.92/33, ZK.1253 Borsh, Himare, Vlorë.

Mbledhja mori sipas rendit të ditës në shqyrtim pikat një nga një dhe e formalizoi të rregullt procedurën.

- Përfaqësuesit ligjor të Ortakëve të shoqërisë **"Grand Hotel Borsh" sh.p.k**, me Numër Unik M01414027F, nuk kanë kundërshtime dhe janë dakort për fillimin e procedurës së vlerësimit të zmadhimit të kapitalit nga kontributet në natyrë me aktive dhe caktimin e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël të Regjistruar) për të bërë vlerësimin nëpërmjet një raporti të posaçëm.

Në përfundim të diskutimeve, Përfaqësuesit ligjor të Ortakëve të Shoqërisë bazuar në nenin 81, të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008* Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare *, i ndryshuar :

V E N D O S E N:

1.Të miratojnë fillimin e procedurës së vlerësimit të zmadhimit të kapitalit me kontribute në natyrë dhe në para.



2.Të pranojne fitimin e të drejtës mbi pronat të cilat janë transferuar nga Ortakët e Shoqërisë *Grand Hotel Borsh* sh.p.k, aktive që do të kalojnë në zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë.

3. Të miratojnë fitimin e të drejtës mbi detyrimet të cilat janë pranuar për transferim me heqje dore ndaj së drejtës monetare nga Ortakët e Shoqërisë *Grand Hotel Borsh* sh.p.k, detyrime që do të kalojnë në zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë në formë kontributi në para.

4.Të miratojnë caktimin e Audituesit Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) z.Halim Bakalli me Liç. 103, për hartimin e raportit të posaçëm, për vlerësimin e kapitalit nga kontribut në natyrë më aktiv dhe nga kontribute në para sipas të dhënave të pronave e të drejtave monetare të listuara më poshtë:

a.Toke Arë me sipërfaqe totale 16,863 m2 me vendodhje Borsh ,Himarë, pronë e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Sarandë ,me numër pasurie 168/33, zona kadastrale nr.1253. Regjistruar Nr. 2494 , Datë 18.02.2022. Pjesa takuese ortaku "Fab Construction" Shpk 60/100. Pjesa takuese ortaku "A.TOTO" Shpk 40/100

b.Toke Arë me sipërfaqe totale 1,497 m2 me vendodhje Borsh, Himarë, pronë e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Sarandë ,me numër pasurie 92/31, zona kadastrale nr.1253. Regjisruar Nr.2487 Datë 11.02.2022 Pjesa takuese ortaku "Fab Construction" Shpk 60/100. Pjesa takuese ortaku "A.TOTO" Shpk 40/100

c.Toke Arë me sipërfaqe totale 147 m2 me vendodhje Borsh, Himarë, pronë e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Sarandë, me numër pasurie 92/33, zona kadastrale nr.1253. Regjistruar Nr 2487 Datë 11.02.2022. Pjesa takuese ortaku "Fab Construction" Shpk 60/100.Pjesa takuese ortaku "A.TOTO" Shpk 40/100

d.Të drejtën monetare në vlerën **399,887,311 lekë.**

5.Të bëhet publikimi i ketij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë ose një i autorizuar prej tij.

6.Vendimi të perpilohet në 4 kopje të barazvlefëshme ku dy kopje të depozitohen pranë selisë së shoqërisë.

Përfaqësuesit e Asamblesë së Përgjithëshme

A.TOTO Sh.p.k

Andrea Toto



Fab Construction Sh.p.k

Shaban Xhabrahimi

